



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2139/12 prot.

Datë 15.12.2022

V E N D I M
Nr. 1252/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “READ 2000” SHPK në procedurën e prokurimit publik “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-43524-09-27-2022, me objekt “Blerje bojë për printera dhe fotokopje”, me fond limit 3,757,319 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

Ankimues: “READ 2000” SHPK
Adresa: Rr. “Shkëlqim Fusha”, Zona Kadastrale 3292, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: “ALBPETROL” SHA
Rr. “Fier-Patos”, Km. 7, Patos

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.09.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-43524-09-27-2022, me objekt “Blerje bojë për printera dhe fotokopje”, me fond limit 3,757,319 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 31.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II.2. Në datën 11.11.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 07.11.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

-	“MARKETING&DISTRIBUTION” SHPK	3,413,322	lekë	kualifikuar
-	“MAGRIP BANA” SHPK	3,612,400	lekë	skualifikuar
-	“COLOMBO” SHPK	2,955,000	lekë	skualifikuar
-	“READ 2000” SHPK	1,965,000	lekë	skualifikuar
-	“ADD PRINT” SHPK	1,889,000	lekë	skualifikuar
-	“BLUEPRINT TECHNOLOGIC” SHPK	0	lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 10.11.2022 operatori ekonomik “READ 2000” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij, në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik “READ 2000” SHPK nuk ka paraqitur mostrat sipas kërkesës së pikës b), të pikës 3 “Specifikime teknike për bojë printer dhe fotokopje”, të Shtojcës 5 “Formular i specifikimeve teknike”, të DST-së. Mostrat e paraqitura janë prodhim i “Laser Toner” dhe nuk janë origjinale të prodhuesit të pajisjeve ose ekuivalente (me përjashtim të mostrës nr. 12 që është origjinale).

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 21.11.2022, operatori ekonomik ankimues “READ 2000” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij me argumentin se: *“Ne jemi në përputhje me gjysmen e OE fituese, për arsye se është një vlerë e mjaftueshme për produktete compatible/ekuivalente të kërkuara në ftesën për ofertë nga AK. Për rrjedhojë të kriterëve të vendosura dhe të kostove të produkteve edhe OE që është shpallur fitues do të sjellë të njëjtat produkte compatible/ekuivalente, por me vlerë dyfish më të lartë. Pra kemi të bëjmë me shpenzime ë panevojshme dhe të tepërta për shtetin.....*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesave, i publikoi ato në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2139/10 prot., 22.11.2022, u publikuan arsyet e skualifikimit të operatori ekonomik ankimues “READ 2000” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 6985/17 prot., datë 30.11.2022 me objekt: “Dërgim vendimi”, protokolluar me tonën me nr. 2139/11 prot., datë 02.12.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit

Publik vendimi i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “READ 2000” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentin se: *“Data e shpallejs së fituesit nga ana e autoritetit kontraktor rezulton më 11.11.2022. Data e depozitimit të ankesës së OE “READ 2000” shpk rezulton më 21.11.2022, pra jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në LPP”* në të cilën është vendosur:

1. *Të refuzojë ankesën e operatorit ekonomik “READ 2000” SHPK. Për procedurën e prokurimit me objekt “ Blerje bojë për printera dhe fotokopje”, REF-34352-09-27-2022.*
2. *Ky vendim i komunikohet Titullarit të Autoritetit Kontrakt, Z. Eltar DEDA.*
3. *Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

II.8. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, nuk është paraqitur asnjë argument nga operatorë ekonomikë të interesuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 28.09.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-43524-09-27-2022, me objekt “Blerje bojë për printera dhe fotokopje”, me fond limit 3,757,319 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

III.1.1. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 21.11.2022, operatori ekonomik ankimues “READ 2000” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij me argumentin se:*“Ne jemi në përputhje me gjysmen e OE fituese, për arsye se është një vlerë e mjaftueshme për produktete compatible/ekuivalente të kërkuara në ftesën për ofertë nga AK. Për rrjedhojë të kritereve të vendosura dhe të kostove të produkteve edhe OE që është shpallur fitues do të sjellë të njëjtat produkte compatible/ekuivalente, por me vlerë dyfish më të lartë. Pra kemi të bëjmë me shpenzime ë panevojshme dhe të tepërta për shtetin.....*

III.1.2. Me shkresën nr. 6985/17 prot., datë 30.11.2022 me objekt: “Dërgim vendimi”, protokolluar me tonën me nr. 2139/11 prot., datë 02.12.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “READ 2000” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit me

argumentin se: “Data e shpallejs së fituesit nga ana e autoritetit kontraktor rezulton më 11.11.2022. Data e depozitimit të ankesës së OE “READ 2000” shpk rezulton më 21.11.2022, pra jashtë afatit 7 ditor të parashikuar në LPP” në të cilën është vendosur:

1. Të refuzojë ankesën e operatorit ekonomik “READ 2000” SHPK. Për proedurën e prokurimit me objekt “ Blerje bojë për printera dhe fotokopje”, REF-34352-09-27-2022.
2. Ky vendim i komunikohet Titullarit të Autoritetit Kontrakt, Z. Eltar DEDA.
3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.3. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “READ 2000” SHPK dhe e ka njoftuar atë dhe Komisionin e Prokurimit Publik, se ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur dhe ka vendosur mos pranimin e saj.

III.1.4. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.5. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, u konstatua se, për këtë procedurë prokurimi ka operator ekonomik të kualifikuar dhe referuar nenit 97 pika 2 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku parashikohet se “Menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktor publikon në sistemin e prokurimit elektronik njoftimin e fituesit. Me publikimin e njoftimit të fituesit në sistemin e prokurimit elektronik, operatorëve ekonomikë i lind e drejta e ankimit sipas parashikimeve të nenit 109 të këtij ligji”, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit për këtë procedurë prokurimi me datë 11.11.2022, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues “READ 2000” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor me datë 21.11.2021 dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 21.11.2021.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në **procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë**”.

III.1.7 Referuar parashikimeve të sipërcituara, në rastin konkret, duke qenë se procedura e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në lidhje me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, nis ditën e publikimit të publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon ditën e 7-të. Duke u bazuar në faktin që ankimuesi është vënë në dijeni më anë të SPE mbi publikimin e njoftimit të fituesit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi me datë 11.11.2022, është pikërisht kjo datë nga ku fillon afati 7 ditor i ankimimit.

Për sa më sipër, ankesa e depozituar njëkohësisht në autoritetin kontraktor në datën 21.11.2022, dhe në Komisionin e Prokurimit Publik konsiderohet e dorëzuar jashtë afatit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

III.1.8 Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “READ 2000” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës

financiare për ankesën me nr prot 2139/9, datë 21.11.2022 të opertorit ekonomik, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.9. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, nuk plotëson një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës atë të pagimit të tarifës financiare si dhe nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit ndaj kjo përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimesi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “READ 2000” për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*” me Nr. REF-43524-09-27-2022, me objekt “*Blerje bojë për printera dhe fotokopje*”, me fond limit 3,757,319 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro